KRONIKË E ZEZË

Policia thotë se shtiu me armë pasi u sulmua në Leposaviq, serbët pretendojnë se u plagos një person

Foto ilustrim: Driton Paçarada

23 janar 2023, 14:17

Shpërndaje në

Një njësi policore është sulmuar të hënën në Bistricë të Leposaviqit nga një veturë që po tentonte ta ndalojë për kontroll.

Policia ka njoftuar se vetura gjatë lëvizjes ka goditur automjetin e Policisë, duke rrezikuar drejtpërdrejt jetën e zyrtarëve policorë.

Me qëllim që ta neutralizojnë rrezikun ndaj tyre, policia kanë shtënë me armë zjarri.

Të dyshuarit kanë arritur të largohen nga vendi i ngjarjes.

"Personat e dyshuar, së bashku me mjetin e tyre janë larguar nga vendi i ngjarjes, përderisa hetimet lidhur me rastin janë duke u kryer, në bashkëpunim dhe koordinim me organet e drejtësisë. Lidhur me rastin, Policia e Kosovës ka njoftuar edhe Inspektoratin Policor të Kosovës për procedura të mëtejme", thuhet më tej në njoftim.

Drejtori i Zyrës për Kosovën në Qeverinë e Serbisë, Petar Petkoviq, ka pretenduar se pjesëtarët e policisë speciale ROSU kanë qëlluar rreth orës 11:30 në pikën e kontrollit ilegal në urën e Bistricës në një veturë me dy serbë dhe se njëri nga ta është plagosur.

"Deleviq është goditur në pjesën e krahorit të majtë dhe ka një plagë me armë zjarri me të cilën është transportuar urgjentisht në spitalin e Kraljevës. Bashkëdrejtuesi i tij Dushan S. fatmirësisht nuk ka mbetur i lënduar, ndërsa e gjithë vetura ka qenë e qëlluar", ka thënë ai për Kosovo Online.

Petkoviq pretendon se pjesëtarët e forcave speciale Rosu kanë qëlluar me bresherë zjarri ndaj veturës serbe dhe serbëve në të vetëm sepse nuk kanë dashur të lejojnë policinë Rosu që t'i keqtrajtojë pa asnjë bazë dhe arsye.

Për rastin e ndodhur në Bistricë të Leposaviqit ka reaguar edhe Lista Serbe. Kjo parti ka akuzuar Policinë e Kosovës se ka qëlluar për t'i vrarë personat që ishin brenda veturës.

"Lista Serbe me muaj të tërë ka insistuar në të gjitha takimet që njësitë speciale të tërhiqen nga veriu i Kosovës dhe M. sepse janë atje ilegalisht dhe shkaktuan një sërë incidentesh, por të gjithë heshtin. Me sa duket po u dërgojnë mbështetje të heshtur atyre që do të shkaktonin kaos në këtë fushë duke shpërfillur paralajmërimet tona", thuhet në reagimin e Listës Serbe.

Kjo parti më tej ka kërkuar arrestimin e njësitit policor që sipas saj, tentoi ta vrasë Miljan Deleviqin dhe shoqëruesin e tij.

"Edhe një herë theksojmë se prania e mëtejshme e këtyre formacioneve mund të na sjellë në një spirale ngjarjesh që do të rrezikojnë në mënyrë të pakthyeshme paqen në këtë rajon", thuhet më tej në reagim.

© KOHA. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

Komento

#LEPOSAVIQ #POLICIA E KOSOVES

I dënuari për vrasjen e Triumf Rzës thotë se Enver Sekiraqa është i pafajshëm
Dyshohet se vodhi para dhe alkool në dy kafene në Kaçanik, arrestohet 17-vjeçari
Arrestohen nëntë zyrtarë që bënë pranimin e stadiumit në Magure pa i plotësuar kushtet
Ende në gjendje të rëndë shëndetësore 18-vjeçarja që ra nga kati i katërt
Policia nis hetimin për mbishkrimin "Wagner" në Mitrovicë
Një person në Prizren tenton vetëvrasjen me armë zjarri
Vdes një person në një aksident në Prizren

Taboola Feed

Kolltuk masazhues profesional - 73% zbritje! Vetëm 55 000 Lek
megazbritje.al | Sponsored

Treatment That Might Help You Against Knee Pain (Search Here)
Knee Pain Treatments | Search | Sponsored

Borrelli thotë se propozimi evropian ndihmon në tejkalimin e krizave
Përfaqësuesi i Lartë i Bashkimit Evropian për Politikë të Jashtme dhe Siguri, Josep Borrell, u ka bërë thirrje të hënën Kosovës dhe Serbisë që të angazhohen në mënyrë konstruktive pë...
Kohanet

Apartment For Sale In Dubai Might Totally Surprise You
Dubai Properties | Search Ads | Sponsored

TË NGJASHME

"Krizë humanitare", SPK: Policët në Leposaviq e Jarinjë janë të bllokuar qe 8 ditë

Kjo faqe kontrollohet dhe menaxhohet nga KOHA. Të gjitha materialet në të, përfshirë fotografitë, janë të mbrojtura me copyright të KOHA-s dhe për to KOHA mban të drejtat e rezervuara. Materialet në këtë faqe nuk mund të përdoren për qëllime komerciale. Ndalohet kopjimi, riprodhimi, publikimi i paautorizuar qoftë origjinal apo i modifikuar në çfardo mënyre, pa lejen paraprake të KOHA-s. Shfrytëzimi i materialeve nga ndonjë faqe internetі a medium tjetër pa lejen e Grupit KOHA, në emër të krejt njësive që e përbëjnë (Koha Ditore, KohaVision, Koha.net, Botimet KOHA, KOHA Print dhe ARTA), është shkelje e drejtave të autorit dhe të pronës intelektuale sipas dispozitave ligjore në fuqi. Të gjithë shkelësit e këtyre të drejtave do të ballafaqohen me ligjin.